

Eralda CARA

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

QASJA NË DOKUMENTET E PRONËSISË DHE NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I TYRE

***Përmbledhje:** Në këtë punim do të shkruajmë për qasjen në dokumente dhe do të japim një përshkrim të shkurtër të dokumenteve dhe të fondeve arkivore më kryesore që përmbajnë të dhëna pronësie për periudhën pas vitit 1912. Punimi është konceptuar si një narrativë historike me referenca arkivore, i cili do të karakterizohet nga një hyrje e përgjithshme dhe do të vijë në linjë kronologjike me llojin e dokumenteve që ruhen në AQSh, si dhe rëndësinë e tyre në procesin e njohjes së pronës private në Shqipëri. Punimi nuk do të jetë i llojit të paraqitjes të fakteve bruto, të përshkrimit, apo të interpretimit të tipareve të dokumentit, por do ta sjellë fuqinë juridike që ai dëshmon si rrjedhojë e burimit të prejardhjes së tij arkivore. Sigurisht, në qendër të punimit do të qëndrojë arkivi si koncept dhe si model i informimit të shoqërisë*

Në këtë punim do t'i paraqesim shkurt dokumentacionet me karakter pronësor që Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar i ka dhe mënyrën e qasjes në to.

Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë, krahas shumë dokumenteve të fushave dhe veprimtarive të ndryshme shoqërore, të prodhuara nga administrata shtetërore në kohë të ndryshme, të cilat pasqyrojnë etapat historike që ka përshkuar shoqëria, administron edhe shumë dokumente administrative të cilat na japin të dhëna dhe informacione të bollshme lidhur me dëshmitë e pronësisë të shtetasve shqiptarë. E drejta e pronës private është një nga të drejtat më themelore të njeriut dhe një e drejtë kushtetuese e cila garantohet nga neni 41¹ i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.²

Pas ndryshimeve demokratike të viteve 1990 që përjetoi vendi ynë, ashtu si në çdo sferë tjetër, njerëzit e kthyen vëmendjen edhe kah prona private, e cila me kalimin e viteve kishte kaluar në procese të ndryshme dhe në një kalvar të gjatë ndryshimesh në statusin e saj. Me rënien e regjimit komunist nga qeveritë e kohës janë marrë një sërë masash, duke hartuar ligje dhe

¹ Kushtetuta e Republikës e Shqipërisë.

² Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Neni 1, protokolli 1.

rregulla që arkivat, për rrjedhojë edhe informacioni që ato bartnin, të ishin më të prekshme nga shoqëria. Sigurisht se masat e marra ecnin në mënyrë të drejtpërdrejtë me proceset demokratike në Shqipëri. Në këto kushte u krijuan të gjitha hapësirat ligjore të nevojshme që midis Arkivit Qendror Shtetëror dhe mbarë shoqërisë të fillonte një marrëdhënie institucionale komunikimi, duke i vendosur në dispozicion të publikut të interesuar të gjitha fondet arkivore të ruajtura aty. Ky është edhe qëllimi i ekzistencës së arkivave dhe dokumenteve, shfrytëzimi i tyre në shërbim të veprimtarisë shoqërore. Një përjasje kjo krejt e zakonshme dhe normale në çdo vend demokratik dhe në çdo shoqëri demokratike. Kjo i mundësoi një veprimtari normale shoqërisë civile, por edhe transparencë në raport me qytetarët. Duke u njohur me dokumentet arkivore, shoqëria filloi të prekte dhe të kuptonte se marrëdhëniet midis saj dhe shtetit rregulloheshin nëpërmjet këtyre të fundit. Në këtë mënyrë vetëm nëpërmjet dokumentit arkivor qytetari u vendos në pozitë të barabartë me institucionin, në të drejtën për këshillim me përvojën dhe proceset natyrore të fakteve të fiksuara në letër apo në tjetër formë.

Që nga ligji i parë për arkivat, ai i vitit 1993, edhe ligji aktual në fuqi, i japin të drejtë shoqërisë që të njihet me dokumente arkivore të të gjitha llojeve, studimore, biografike apo pronësore qofshin ato. Çdo qytetar që plotëson kushtet që i ka vendosur neni 64 i ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat"³, është i lirë të konsultohet me dokumente që përmbajnë të dhëna pronësie në gjuhën osmane, për dokumentet e prodhuara nga ajo administratë, si dhe në gjuhën shqipe të prodhuara nga administrata shqiptare pas vitit 1912, pa kurrfarë autorizimi.⁴ Ky është një proces që kryhet nëpërmjet shërbimit postar, nëpërmjet shfrytëzimit të sallës së studimit në AQSh apo nëpërmjet shërbimit on-line. Mjafton të jesh nip apo mbesë pronari, stërnip apo stërmbesë e tij, apo edhe vetë personi pronar, për të mos pasur asnjë kufizim informacioni lidhur me dokumentet që disponon AQSh, qofshin këto të viteve apo shekujve të kaluar.

Për nevoja të administrimit të fondit tokësor në vend filluan të ndërtoheshin institucione për administrimin e pronës e, për rrjedhojë, të hartoheshin edhe dokumente për evidentimin dhe regjistrimin e saj. Ashtu si theksuam edhe më lart, në AQSh ruhen një mori dokumentesh të hartuara nga institucione të ndryshme shtetërore. Herë për interes të vetë qytetarëve, siç janë aktet noteriale të shitblerjeve, herë për interesa shtetërore, për regjistrim taksash apo për evidenca të ndryshme me karakter administrativ. Një pjesë e madhe e këtyre dokumenteve mbartin emra konkretë pronarësh, trashëgimtarët e të cilëve i përdorin sot ato si dëshmi të pakontestueshme pronësie nëpër institucionet e ngarkuara me ligj, për trajtimin e pronës në vend. Një rëndësi të veçantë paraqesin dokumentet noteriale të bëra pjesë e

³ Shih ligjin e sipërcituar.

⁴ Shih nenin 54.

fondit arkivor kombëtar në AQSh para pak kohësh. Këto lloj dokumentesh, të hartuar nga dhjetëra noterë në qytetin ku ishin të vendosur, japin të dhëna për të gjitha aktshitblerjet apo dhurimet e pronave të bëra ndërmjet qytetarëve në kohë të ndryshme, hera-herës të shoqëruara edhe me skica të vendndodhjes të pronës. Me një akt noterial në dorë, qytetari paraqitej pranë zyrave të hipotekave ku kryhej regjistrimi dhe kalimi i pronësisë, nga shitësi te blerësi. Po ashtu, një tip dokumenti i quajtur “dëshmi kryepleqësie” mbart një rëndësi të madhe juridike për identifikimin e pronës. Një numër prej trekatër anëtarësh, të kthyer në institucion me vulë e firmë, betoheshin duke u zotuar e dëshmuar, kur një bashkëfshatar i tyre kërkonte vërtetim për pronën e tij. Vërtetimi i lëshuar prej tyre, me sipërfaqen e pronës, kufitarët e saj si dhe toponimin në të cilin ndodhej ajo, ishte i barasvlershëm me një dokument hipotekor i pakontestueshëm nga asnjë institucion i kohës, qofshin edhe ato bankare. Këto institucione⁵, kryepleqësitë, u ngritën me ligj në të gjithë vendin, për arsye se pjesa dërrmuese e pronës ishte e paregjistruar në hipotekë, për rrjedhojë, nuk mund të përdorej në forcimin e gjendjes ekonomike të vendit. Ishte i vetmi dokument pa të cilin bankat e kohës nuk të jepnin kredi për nevojat ekonomike të qytetarëve.

Një peshë specifike të madhe mbajnë dokumentet e Bankës së Napolit apo Bankës Kombëtare të numërtuara me numra fondesh 182 dhe 179 në AQSh. Këto institucione, të themeluara në vitin 1925 e më pas, me dokumentet e hartuara nga ana e tyre, luajnë një rol tepër të rëndësishëm në korpusin e dokumenteve, të lëshuara nga institucionet shqiptare në vite. Këto institucione, përveç dokumenteve të paraqitura nga vetë aplikuesi për kredi, merrnin informacion shtesë, për besueshmërinë e tyre nga njerëz të njohur dhe me integritet të zonës, apo qytetit ku banonte qytetari aplikues.

Edhe gjykatat e kohës kanë ushtruar një veprimtari të dendur lidhur me gjykimet e çështjeve për pronësi, dokumentet e të cilave janë të rëndësishme për vetë peshën juridike që trashëgojnë edhe sot, siç janë dëshmitë e trashëgimive të hartuara nga këto institucione. Gjatë procesit të gjykimit gjykatat mbledhnin prova shkresore nga institucione të ndryshme, mbi bazën e të cilave merrnin vendim mbi objektin e ngritjes së padisë, qoftë ajo tokë, shtëpi, dyqan apo ambiente ku ushtroheshin veprimtari profesionale. Këto lloj dokumentesh japin një ndihmë shumë të madhe në procesin e njohjes dhe kthimit të pronës në ditët e sotshme.

Institucionet lokale si prefekturat, nënprefekturat, bashkitë, drejtoritë e financave, odat e tregtisë etj., gjatë veprimtarisë së tyre administrative kanë regjistruar të gjithë pronat e paluajtshme të mundshme në qytetet e tyre, fondet e të cilave ruhen në AQSh.⁶ Një tipologji tjetër dokumentesh që na japin të dhëna pronësie janë edhe lutjet e personave të ndryshëm drejtuar

⁵ AQSh, F. 149, pa vit, D. 1089, fl. 1.

⁶ AQSh, F. 375, viti 1928, D. 19, fl. 2, 6.

institucioneve qendrore, ku me argumente të ndryshme dëshirojnë që tokat e tyre të mos përfshihen në reformën agrare.⁷

Institucionet qendrore të administratës para vitit 1945, në objektivat e tyre të punës i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë problematikës së pronësisë, shtetërore apo private në të gjithë vendin.⁸

Ministria e Ekonomisë Kombëtare ka evidentuar të gjithë pyjet, shtetërore apo private të kohës, duke hartuar dokumente, raporte dhe relacione për gjendjen, vendndodhjen e tyre, sipërfaqet, pronarët etj., duke i shoqëruar edhe me skica sipas rastit. Ministria e Bujqësisë dhe Pyjeve, në fokusin e punës së saj ka pasur edhe veçoritë e pronës, duke ndjekur në dinamikë procesin e saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Reformës Agrare, institucion i ngritur për implementimin e reformës në vend, ka ndjekur edhe gjithë procesin e vendosjes së emigrantëve në prona shtetërore apo private, të dhuruara këto të fundit nga pronarë të mëdhenj pronash, në qytete dhe fshatra të vendit. Këta emigrantë vinin në Shqipëri nga vise të ndryshme shqiptare të mbetur jashtë hartës natyrale të vendit si pasojë e rrethanave historike tashmë të njohura. Ministria e Punëve Botore ka pasur prioritet të punës së saj ndërtimin e gjithë veprave madhore publike në vend, si aeroportet apo fushat e aviacioneve. Dokumentacioni i shpronësimeve publike, të hartuar nga kjo ministri, është i shoqëruar edhe me harta dhe skica sipas rastit. Ministria e Financave ka udhëhequr, me politikat e saj, procesin e taksimit në vend, që me dokumentacionin e hartuar u vjen në ndihmë trashëgimtarëve të ish-pronarëve me evidenca ku dalin qartazi nocionet pronësore të pasurive të paluajtshme. E kështu me radhë, një numër tepër i madh fondesh arkivore që mbartin në brendësi me qindra mijëra dosje dhe fletë dokumentesh që dëshmojnë për problematikën pronësore në vendin tonë.

Një kthesë shumë të fortë ky proces e merr pas vitit 1945, me ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste, e cila shtetëzoi çdo pronë të të ashtuquajturve armiq të pushtetit.⁹ Pikërisht në këtë periudhë do të nisë rrugëtimi i gjatë 45-vjeçar i tjetërsimit të statusit juridik të fondit tokësor në Republikën e Shqipërisë, i cili, me shtesa të tjera ligjore, pas rënies së atij sistemi në vitet 1990, e ngatërroi edhe më keq fatin e saj. Vetëm pas vitit 1945 janë hartuar me qindra mijëra dokumente nga institucionet e administratës së kohës për evidentimin dhe konfiskimin e pronës në vend, të cilat ruhen në AQSh, të dhëna këto që kanë rëndësinë e vet në plotësimin e figurës, në procesin e njohjes së pronës.

⁷ AQSh, F. 146, viti 1934, D. 35, fl. 1-18.

⁸ AQSh, F. 146, viti 1922, D. 51, fl. 1-71.

⁹ Gazeta Zyrtare nr. 2, dt. 23. 05. 1945, ligji nr. 25, dt. 15. 02. 1944, *Mbi konfiskimin e pasurive të armiqve politikë*.

Pas vitit 1945 noterët kaluan nëpër gjykata, të cilët bënë ndonjë akt shitblerje shtëpie private midis qytetarëve apo ndërmjet shtetit. U formuan komitetet ekzekutive të cilët kishin gjithë fuqinë juridike për marrjen e vendimeve me karakter pronësor si leje ndërtimi, leje meremetimi etj. Ndërsa gjithë fondi tjetër tokësor u kthye thuajse në të gjithë vendin në kooperativa bujqësore.

Kjo që thamë deri tash është vetëm një rrëfenjë tepër modeste, në funksion të temës së zhvilluar, për të kuptuar qindra e mijëra dokumente të tjera që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar, që hedhin dritë mbi çështjet pronësore. Kështu, për 30 vjet me radhë postkomuniste, AQSh është shndërruar në prijësen e fenomenit pronësor. AQSh, me gjithë burimet e saj njerëzore, është kthyer në prijësen e përditshme të kësaj beteje, me dhjetëra kërkesa në ditë, me qindra në muaj dhe me mijëra në vit. E vendosur në krahë të qytetarëve dhe institucioneve në vend, që kërkojnë ndihmën e saj për të kuptuar dhe gjykuar se çfarë ka ndodhur në thellësinë e kohës me këtë problem, e vendosur bindshëm ashtu si e përkufizon edhe literatura arkivore si tempull i kujtesës kolektive dhe në shërbim të saj, si tempull i së vërtetës, si tempull i të drejtës.

Bibliografi:

Burime parësore:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë.

Burime dytësore:

Gazeta Zyrtare nr. 2, dt. 23.05.1945, ligji nr. 25 dt. 15.02.1944, “Mbi konfiskimin e pasurive të armiqve politikë”

Kushtetuta e Republikës e Shqipërisë

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Dispozita ligjore “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë”

Pela, Mihallaq. *Praktika Arkivore në Shqipëri*, Tiranë. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, 2003

